



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/

REPUBLIC OF KOSOVO

Kompania Regjionale e Mbeturinave/ Regional waste Company/

Regionalna Kompanija za Uklanjanja Otpada



KRM "PASTËRTIA" SH.A. FERIZAJ

Rr. "Enver Topalli" Nr. 47 Tel. 0290/325-025

Mbështetur në nenin 8, të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe në bazë të Vendimit me nr. 4933, Kryeshefi Ekzekutiv i KRM "Pastërtia" Sh.A. Ferizaj shpallë:

K O N K U R S

Për vendin e punës:

Nr.Referencës	Pozita	Vend i lirë/ Zëvendësim	Nr. Pozitav	Njësia
1/4990/23	Inkasant	Vend i lirë	2	Kaçanik
2/4990/23	Rojtar	Vend i lirë	2	Kaçanik
3/4990/23	Arkatar/e	Vend i lirë	1	Kaçanik

Përgjegjësi mbikqyrëse: Jo

Raportimi: Udhëheqësve të lëmive përkatës

Orari i plotë i punës: Po

Kohëzgjatja e emërimit, Në kohë të caktuar/ Puna Provuese gjashtë (6) muaj në pajtim me Ligjin e Punës dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit

Koeficientet: Në harmoni me politikat zhvillimore të Kompanisë

Vendi i punës:Kaçanik.

Dokumentet e nevojshme:

- Aplikacionin për punësim;
- CV-ja;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmia për kualifikim: Diplom e Shkollës së Mesme;
- Dëshminë që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj.
- Kandidati i cili arrin pikët e mjaftushe për pranim, është i obliguar të sjellin Çertifikatë shëndetësore.

Përshkrimi i vendit të punës dhe përvoja e punës:

Inkasant:

Bënë inkasimin e mjeteve në bazë të faturave me të cilat ngarkohet materialisht, bënë zbulimin- regjistrimin me kohë të sipërfaqeve të reja dhe të paregjistruara dhe përcjell ndryshimet apo ndërrimet e sipërfaqeve dhe ndryshimet tjera të nevojshme në sektorin e amvisëris respektivisht komercial duke e nojftuar Shërbimin e faturimit.

Kualifikimi: Diplomën e Shkollës së Mesme.

Rojtar:

Kujdeset për ruajtjen e pasurisë-objekteve dhe mjeteve themelore të Ndërmarrjes . Bënë shikimin e rregullt të objekteve dhe lokacionit në të cilin është i caktuar sipas orarit mujor. Mban evidencën në librin e rojës për ndërrimin e tij. Kryen punët dhe detyrat e punës sipas urdhëresës së përgjegjësit të drejtëpërdrejtë.

Kualifikimi: Diplomën e Shkollës së Mesme.

Akatar/e:

Bënë inkasimin e mjeteve nga shfrytëzuesit sipas vërejtjeve dhe specifikacionit mbi ngarkesën me fletëpagesë. Përcjellë dhe evidenton kërkesat dhe ankesat nga shfrytëzuesit e shërbimeve dhe bashkëpunon me departamentet, menaxherët dhe shërbimet në ndërmarrje, në funksion të furnizimit të shfrytëzuesve me shërbime. Paraqet raportet mujore mbi kërkesat dhe punën nga rrethveprimi i shërbimit. Kryen punët dhe detyrat e punës sipas urdhëresës së udhëheqësit të drejtëpërdrejtë dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

Dëshmia për kualifikim: Diplomën e Shkollës së Mesme.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Aplikacioni mund të merret në zyret e KRM "Pastërtia" Sh.A. Ferizaj, Rr."Enver Topalli" Nr.47 Ferizaj, ku edhe bëhet dorëzimi i Aplikacionit së bashku me dokumantacionin e kërkuar, apo mund të shkarkohet edhe në web-faqen e Kompanisë: www.pastertia.com.

Afati i konkursit për aplikim është i hapur 15 ditë kalendarik nga dita e publikimit në web-faqen e Kompanisë si dhe në shtypin ditor, duke filluar nga data **24.11.2023 deri 08.12.2023 ora 16:00.**

Për informata shtesë mund të kontaktoni numrin e tel. 0290/325-025.